



UNICEF
SHQIPËRI


PROJEKTI CLEEN – FLETORJA E NXËNËSIT
KLASA E PARË

Pergatitur nga: Raiha Idrees

Emri im eshte _____

**Une dua qe Shqiperia ime te jete e bukur dhe e
paster**

UJI



UJI
PËRDORENI
ME KUJDES

Tema: Përdorimet e ujit

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Pikturoni një nga përdorimet që ka uji.

Materialet: letër, lapsa me ngjyra (ngjyrosës) ose lapustila

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Bëni një pikturë që tregon si e përdorni ujin në shtëpi.

Ngjyroseni pikturën.

A large dashed rectangular box intended for the student to draw a picture showing how they use water at home. The box is empty and occupies the lower half of the page.

Tema: Burimet e ujit - nga vjen uji

Aktiviteti # : Dy

Aktiviteti: Kombinim - Kombinoni burimin e ujit me fjalën e duhur

Materialet : laps dhe gomë

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve





Oqeanet

Ujvarat

Retë dhe
shiu

Ajsbergët

Tema: Ruajtja e Ujit

Aktiviteti # : Tre

Aktiviteti: Ngjyrosini këto tabela të rrumbullakëta dhe vendosini në shkollë e shtëpi

Materialet: Lapsa me ngjyrë, lapustila, gërshërë, spango

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi



Kursimtar i ujit

Tema: Uji

Aktiviteti # 4

Aktiviteti: Vizatim - Të krijosh një lumë

Materialet: letër dhe lapsa me ngjyrë

Hapi Fëmija për Fëmijën: Planifikimi dhe realizimi

Të krijosh një lumë

Qëllimi i lojës:

Të ruajmë ujin e lumenjëve dhe përrenjve

Pikturoni në një letër vizatimi një lumë. Drejtimi i lumit të jetë në drejtim horizontal me fletën.

Pasi të keni mbaruar së vizatuari, mblidhni fletët. Ju keni krijuar një lumë me të gjitha pjesët e tij.


Bashkoni çdo pjesë të vizatimit deri në fund, kështu uji do të lundrojë përgjatë lumit.

Cfarë ndodh me cilësinë e ujit në kohën që lumi lundron?

Cfarë ka ndërtuar njeriu përgjatë lumit? Nga se ndotet uji i lumit?

Si mund t'i ruajmë përrenjtë apo lumenjtë? .C'mund të bëjmë ne që lumenjtë të kenë ujë të pastër?

Kjo lojë mund të realizohet dhe në formën e një ekskursioni përgjatë një pjese të lumit.



Tema: Uji

Aktiviteti # : 5

Aktiviteti: Mbledhja e ujit të shiut

Materialet: mbajtëse plastike apo enë e riciklueshme

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

1. Gjeni një mbajtëse plastike apo enë të riciklueshme.
2. Kur të bjerë shi, vendoseni në një vend të hapur.
3. Sa ujë keni mbledhur në enë?
4. Eshtë mbushur ena plot, përgjysëm apo është thuajse bosh?
5. Ç'ngjyrë ka uji që keni mbledhur?
6. Është i pastër apo i ndotur?
7. Çfarë keni ndër mend të bëni me ujin?
8. Vizatoni enën. A mund të vizatoni edhe sasinë e ujit që keni mbledhur?

AJRI



Tema: Ajri


Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Nga vjen era e keqe?

Materialet: Laps dhe gomë

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Rrethoni sendet më poshtë që e bëjnë ajrin të pistë dhe të ndotur.



Tema: Ajri

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Kur ajri ka erë të mirë dhe kur ajri ka erë të keqe (Art)

Materialet: Piktura të Arushit Tedi i lumtur (një për çdo fëmijë), Piktura të arushit Tedi i mërzhitur (një për çdo fëmijë), Piktura të gjërave që vijnë erë të mirë, Piktura të gjërave me erë të keqe, Shkop doktorit për grykët ose shkop për të përzier (dy për fëmijë), ngjyrosës, gërshtë, ngjitës

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Objektivi:

Të mësojnë fëmijët se tymi ka erë të keqe.

Aktiviteti:

Hapi 1: Ngjyrosni pikturën e Arushit të lumtur Tedi ndërsa flisni për gjëra që kanë erë të mirë.

Hapi 2: Ngjyrosni pikturën e arushit Tedi duke mbajtur hundën ndërsa flisni për gjëra që kanë erë të keqe.


Hapi 3: Pritini pikturat e arushëve të lumtur.



Hapi 4: Ngjyrosini pikturat e sendeve që vijnë erë.


Hapi 5: Pritini pikturat e Tedit duke mbajtur hundën


Hapi 6: Ngjitini të dy pikturat e Tedit tek shkopinjtë e grykëve.

Hapi 7: Kur të jetë tharë ngjitësi, ngrini lart një nga pikturat e sendeve që vijnë erë. Vendosini pikturat që vijnë erë të mirë pranë arushit të lumtur Tedi dhe ato me erë të keqe pranë arushit Tedi që mban hundën me dorë.









Tema: Ajri

Aktiviteti # : Tre

Aktiviteti: Cilat sende i tund era?

Materialët: Laps dhe gomë

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Balonat, rrobat e varura në tel, gjethet e thata, të gjitha këto i merr era. A mund të mendoni të tjera? A mund t'i vizatoni dhe të shkruani emrat e tyre?

Tema: Ajri

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Poemë për ajrin

Materialet: Poema e shkruar

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

A mund ta recitoni këtë poemë? A mund të bëni edhe ju një të tillë? Doni ta provoni?

Ere e lehte, fry mbi koder
Ere e lehte, fry mbi fushe;
Ere e lehte na sill diellin
Ere e lehte na hap qiellin.

Erë e lehtë

Kate Greenaway, Marrë nga 'Under The window' 1910

Tema: Ajri

Aktiviteti #: Gjashtë

Aktiviteti: Gjëagjësë

Materialet: Gjëagjësë

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Rreth e qark tokën mbështjell
Si një vello, si mantel,
Dot me sy nuk e shikojmë,
Por pa të nuk mund të rrojmë

S'rrojmë ne, as kafshë, as bimë,
Këtë që të gjith' e dimë.
Pa të nuk do t' kishte jetë,
Bota do të ishte e shkretë,

S'ka aromë, s'ka as ngjyrë,
Por e ndiejmë në fytyrë,
Me shpesh herët në agim,
Verës fllad, dimrit thëllim,

Veç kur nxehet, fryn me vrull
Dhe lisin nga rrënjët shkull.
Ka azot dhe oksigjen
T'ia thot' emrin kush ia gjen.

Shkruar nga: Stefan Buló

TOKA



Tema: Toka

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Dita dhe Nata

Materialet: Lapustila, ngjyrosës, lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

A mund të bëni pikturën e ditës në njërën anë dhe të natës në anën tjetër? Çfarë gjërash shikoni në qiell gjatë ditës? Çfarë gjërash shikoni në qiell gjatë natës?

Ditë	Natë

Tema: Toka

Aktiviteti # : Dy

Aktiviteti: Çfarë shoh, dëgjoj, nuhas, ndjej dhe shijoj

Materialet: Ngjyrosës, lapustila, lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

A mund të vizatoni disa nga gjërat që i **dëgjojmë** në tokën tonë?

A mund të vizatoni disa nga gjërat që i **shohim** në tokën tonë?

A mund të vizatoni disa nga gjërat që i **nuhatim** në tokën tonë?

A mund të vizatoni disa nga gjërat që i **ndjejme** në tokën tonë?

A mund të vizatoni disa nga gjërat që i **shijojmë** në tokën tonë?

Tema: Toka

Aktiviteti #: Tre


Aktiviteti: Sendet e lëvizshme të tokës

Materialet: Material i riciklueshëm, spango, pjatë letre, sende të gjetura në mjedis

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Çfarë do të bëni:

- Së pari, prisni spangon në copa nga 10 deri në 15 cm.
- Pastaj, lidhni me spango gjërat e gjetura në mjedis.
- Bëni ca vrima në pjatën prej letre, kaloni spangot në çdo vrimë dhe bëni nyje fundin e spangos që të mos dalë nga vrima.
- Së fundi, lidhni tre copa spangoje në anën e sipërme të pjatës.



- Opsionale: zbukuroni pjatën e letrës me ngjyrosës, bojëra, ose letra me ngjyra.

Tema: Toka

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Të bëjmë shportat e tokës

Materialet: Shporta, materiale të mbledhura andej- këtej nëpër mjedis

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Shporta e thesarit



- Shporta e thesarit ka shumë gjëra brenda saj.
- Gjeni një shportë që nuk përmbysset lehtë.
- Mbusheni shportën me sende që i gjeni në mjdisi. P.sh.: gjethe, degë, guralecë, guacka, etj.
- Zgjidhni gjëra që ia vlen t'i prekësh, t'i nuhasësh dhe t'i shohësh.
- Ato duhet të jenë të ndryshme në formë, ngjyrë, gjatësi, etj.
- Tregojani shportën shokëve dhe njerëzve të shtëpisë.
- Flisni për gjërat e shportës dhe pse gjenden ato aty.

NATYRA



Tema: Natyra

Aktiviteti#: Një

Aktiviteti: Diskutim mbi pikturën

Materialet: Lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Më poshtë gjendet piktura e një kopshti. Shikojeni me kujdes. Çfarë shikoni? Çfarë kafshësh gjenden aty? Ku janë ato? Çfarë po bëjnë? Tani mund të vizatoni një kopësht ose natyrën që shihni përreth jush.



Piktura nga Lucky Magnolia (Susan Shie)

Tema: Natyra

Aktiviteti # :Dy

Aktiviteti: Ta këputësh apo të mos e këputësh

Materialet: letër, laps

Hapi Fëmija për Fëmijën: Të Kuptuarit

Përgjatë eskursionit zgjidhni një vend, i cili sipas mendimit tuaj ka shumë vegjetacion (bimësi).A dini ndonjë emër që përdoret në vegjetacion (bimësi)?

Vëzhgoni çdo bimë që ju duket interesante dhe e veçantë. Uluni afër bimës. Secili të ulet pranë një bime te preferuar.

Mundohuni t'u jepni përgjigje këtyre pyetjeve:

A janë më shumë se 100 bimë të të njëjtit lloj që bëjnë pjesë në këtë zonë?

A mund të mësoj diçka për këputjen e bimëve, gjë të cilën nuk mund ta mësoj duke mos i këputur ato?

Tema: Natyra

Aktiviteti#: Tre

Aktiviteti: Riciklimi... Çfarë hedhim në kosh

Materiale: Për të bërë lidhjen

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Disa gjëra mund të riciklohen ... të tjerat jo. Çfarë sendesh hedhim në koshin e riciklueshëm? Lidheni sendin me koshin.

			
			
 bojera	 qumesht		

Tema: Natyra


Aktiviteti#: Kater

Aktiviteti: Plotësimi i figurave

Materiale: Skicat, lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Shikoni me kujdes figurat e mëposhtme. Përfundoni vizatimin e kafshës dhe vendosini dhe emrin.



Tema: Natyra

Aktiviteti # :Pesë

Aktiviteti: Piktura mbi tullumbace

Materialet: lapustila, markera, tullumbace

Hapi Fëmija për Fëmijën: Të Kuptuarit

Sodisni peisazhin që ju rrethon për disa minuta. Më pas, vizatoni në tullumbace atë që keni parë në natyrë. Mund të pikturoni pemë, lule, flutura, zogj, insekte, ose cfarëdo tjetër që ju shihni.

NDOTJA



Tema: Ndotja


Aktiviteti#: Një

Aktiviteti: Njohja e pikturave

Materialet: Lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Shikoni pikturën më poshtë. Çfarë shikoni se po ndodh në këtë pikturë? Ç'është ajo gjëja e zezë? Ç'mund t'u ndodhë kodrave? Nga vjen tymi i zi? Pse nxjerrin tym të zi ato ndërtesa? Mendoni se ky tym i zi është i mirë për ne? A mund të na bëjë keq ky tym neve? Si?



Nga ku tjetër del tym i zi? A mund të bëni një pikturë të një sendi që nxjerr tym të zi?

Tema: Ndotja

Aktiviteti#: Dy

Aktiviteti: Nga dalin zhurmat e forta

Materialet: Lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Zhurme, Zhurme, Zhurme. A mund të sillni ndër mend gjërat që bëjnë zhurmë të madhe? Zhurma nuk na pëlqen. A mund të pikturoni gjërat që bëjnë zhurmë të madhe?

A dashed rectangular box for drawing or writing.

Tema: Ndotja

Aktiviteti#: Tre

Aktiviteti: Shishet e riciklueshme dhe një këngë

Materialet: shishe plastike, gazeta.

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Më poshtë është një këngë ... a mund ta këndonni ... Është qejf të këndosh

Ne riciklojmë

(Ura e Londrës)

Ne riciklojmë gazeta, gazeta, gazeta.

Ne riciklojmë gazetat për të shpëtuar planetin.

Gazetat bëhen kuti për biskota, biskota, biskota.

Gazetat bëhen kuti biskotash për të shpëtuar planetin.

Ne riciklojmë shishe plastike, shishe plastike, shishe plastike.

Ne riciklojmë shishe plastike për të shpëtuar planetin.

Shishet plastike bëhen tavolina pikniku, tavolina pikniku, tavolina pikniku.

Shishet plastike bëhen tavolina pikniku për të shpëtuar planetin.

Ne do të përdorim më pak gjëra, më pak gjëra, më pak gjëra.

Ne do të përdorim më pak gjëra për të shpëtuar planetin.

Për të shpëtuar planetin!

Mblidhni shishet plastike dhe gazetat që nuk përdoren në shtëpi.

Sa shishe keni mbledhur?

Sa gazeta keni gjetur?

Bashkë me nënën, babanë, vëllanë ose motrën mblidhni gazetat dhe shishet plastike.

Gjeni një vend ku t'i vendosni për riciklim.

Ndihmoni nënën dhe babanë për të ricikluar shishet dhe gazetat.

Tema: Ndotja

Aktiviteti#: Katër

Aktiviteti: Ripërdorimi i qeseve plastike në shtëpi

Materialet: qese plastike

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

- A keni qese plastike në shtëpi?
- Nga vijnë ato?
- Çfarë i bëni qeset plastike kur ktheheni nga pazari në shtëpi?
- Numëroni qeset plastike që keni në shtëpi.
- A mund t'i përdorni prapë?
- Si?
- Çfarë mund të bëni me to?
- Pyesni nënën dhe babanë se çfarë mund të bëni me qeset që keni në shtëpi.



Tema: Ndotja

Aktiviteti#: Pesë

Aktiviteti: Vizatim

Materialet: Lapsa, lapsa me ngjyra, shënjes

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

A e dini çfarë është ndotja? Keni mësuar për llojet e ndryshme të ndotësve. Mendoni për një lloj ndotjeje ... ajër, ujë ose zhurmë. Bëni një pikturë për atë lloj ndotjeje dhe për mënyrën sesi e dëmton ajo botën. Flisni për pikturën me njerëzit e shtëpisë dhe me shokët.

MBESHTETUR NGA:

UNICEF ALBANIA



THE CHILD TO CHILD TRUST



AMBASADA E MBRETERISE HOLLANDEZE



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCES
INSTITUTI I KURRIKULES DHE TRAINIMIT



MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TE UJERAVE

